



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

RREGULLORE

**PËR
PËRLLOGARITJEN E VLERËS NETO TË ASETEVE TË FONDIT TË
PENSIONIT VULLNETAR DHE AFATET E PUBLIKIMIT TË
INFORMACIONIT**

Miratuar me Vendimin e Bordit nr. 139, datë, 26.09.2012

Ndryshuar me Vendimin e Bordit nr. 3, datë 22.01.2020

**Neni 1
Baza Ligjore**

Kjo rregullore hartohet në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

**Neni 2
Objekti**

Kjo rregullore përcakton:

1. Mënyrën e vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve të fondit të pensionit, përllogaritjen e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit dhe vlerës së kuotës së fondit të pensionit;
2. Shpeshtësinë e llogaritjes së vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit, si dhe mënyrën dhe kohën e publikimit të informacionit.

**Neni 3
Përkufizime**

1. Për qëllim të kësaj rregullore termi:

- a) “Ditë vlerësimi”- nënkupton ditën “t” në të cilën bëhet përllogaritja e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit mbështetur në të dhënat e mbylljes së një ditë më parë “t-1”.
- b) “Ditë e shlyerjes së transaksionit” – nënkupton ditën e pagesës ose arkëtimit të shumës përkatëse, në rastin e blerjes apo shitjes së asetit financiar.
- c) “SNK”- nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

d) “SNRF”- nënkupton Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

2. Termat e tjerë të përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim dhënë atyre në Ligjin nr. 10 197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”.

Neni 4

Vlera neto e aseteve dhe vlera e kuotave të fondit të pensionit

1. Vlera totale e aseteve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit, është shuma e vlerave të të gjitha llojeve të aseteve të lejuara nga ligji dhe aktet nënligjore dhe të përcaktuara në prospekt në përputhje me objektivat e investimit të fondit të pensionit.
2. Detyrimet e fondit të pensionit përfshijnë:
 - a. Detyrimet në formën e pensionit të anëtarëve,
 - b. Detyrimet për tërheqjet e parakohshme.
 - c. Detyrimet për transferimin e aseteve në një fond tjetër dhe tarifës që lidhet me transferimin,
 - d. Detyrimet për tarifën e administrimit,
 - e. Detyrimet e lindura nga blerja e aseteve deri në përfundim të procesit të shlyerjes, kur njohja e transaksionit bëhet në datën e tregtimit,
 - f. Të tjera detyrime të përcaktuara nga ligji.
3. Vlera neto e aseteve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit (t), rezulton nga diferenca mes vlerës totale të aseteve të fondit të pensionit, të një dite më parë (t-1), me totalin e detyrimeve të fondit të pensionit të po asaj dite (t-1).
4. Vlera neto e aseteve për çdo kuotë pensioni, në ditën e vlerësimit, do të llogaritet duke pjesëtuar vlerën neto të aseteve të fondit të pensionit me numrin total të kuotave të pensionit.
5. Numri total i kuotave të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit, llogaritet duke i shtuar numrit të kuotave të pensionit, të ditës (t-2), numrin e kuotave që fondi i pensionit emeton për kontribuuesit gjatë ditës (t-1), të cilët kanë paguar kontributet në ditën (t-1), si dhe duke zbritur numrin e kuotave të tërhequra nga fondi i pensionit në formën e pagesave për pension, apo të transferuara në një fond tjetër, në ditën (t-1).
6. Kuotat e pensionit të emetuara dhe të tërhequra nga fondi i pensionit regjistrohen në llogaritë personale të anëtarëve të fondit në të njëjtën ditë të emetimit apo tërheqjes.
7. Shoqëria administruese e cila është përgjegjëse për llogaritjen e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit dhe banka depozitare e cila konfirmon vlerësimin duhet të përputhin me njëra-tjetrën në ditën e vlerësimit vlerën neto të aseteve dhe numrin e kuotave të fondit të pensionit.

Neni 5

Vlerësimi i aseteve dhe detyrimeve të fondit të pensionit

1. Metoda e vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve financiare të fondit të pensionit do të bazohet në dispozitat e kësaj rregulloreje dhe parimet e SNRF-së.
2. Njohja fillestare (*initial recognition*) e aseteve duhet të jetë në përputhje me SNK 39.

3. Asetet e blera në një monedhë të huaj, do të llogariten në ekuivalentin në Lekë duke zbatuar normën e kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fuqi në ditën e transaksionit. Në rastin kur monedha në të cilën janë blerë asetet nuk është përfshirë në listën e normave të kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, do të përdoren normat mesatare të kursit të këmbimit të kësaj monedhe me euron, marrë nga bankat qendrore respektive dhe vlerat e paraqitura në euro, duhet të kthehen në ekuivalentin e tyre në lekë duke zbatuar kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fuqi në ditën përkatëse.

Neni 6

Llogaritjet në vijim të vlerës së aseteve dhe detyrimeve

1. Llogaritjet në vijim të vlerës së aseteve dhe detyrimeve të fondit të pensionit do të kryhen në varësi të llojit dhe klasifikimit të asetit sipas SNK 39.
2. Llogaritjet në vijim të vlerës së aseteve dhe detyrimeve të fondit të pensionit shprehur në një monedhë të huaj, bëhen duke zbatuar kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fuqi në ditën e vlerësimit.

Neni 7

Njohja e transaksionit financiar

1. Blerja dhe shitja e aseteve financiare, do të përfshihen në vlerësimin e aseteve të fondit të pensionit në ditën e shlyerjes së transaksionit, në bazë të vlerës së drejtë në ditën e tregtimit.
2. Transaksionet e kryera dhe detyrimet e fondit duhet të regjistrohen në librat kontabël, në bazë të dokumenteve kontabël të besueshme dhe të vërteta, sipas vlerës së transaksioneve.
3. Të drejtat apo detyrimet që burojnë nga dividendët, interesat, humbjet ose fitimet nga diferenca e çmimit të asetit financiar do të përfshihen në shumën totale të aseteve apo detyrimeve të fondit pasi të jetë marrë vendimi i organit kompetent dhe të jetë përcaktuar e drejta për arkëtim apo pagesa për detyrim.

Neni 8

Llogaritja e aseteve financiare sipas vlerës së drejtë (*fair value*)

1. Për letrat me vlerë të kapitalit aksionar dhe të borxhit afatgjatë që tregtohen në Republikën e Shqipërisë, vlera e drejtë, do të llogaritet duke zbatuar çmimin mesatar të shitjeve ditore, të llogaritur nga ponderimi i çmimeve ditore të asaj letre me vlerë me sasinë e letrës me vlerë të tregtuar në Bursë, e rumbullakosur në katër shifra pas presjes dhjetore.
2. Për letrat me vlerë të kapitalit aksionar të tregtuara në tregjet e BE-së apo në tregjet likuide të vendeve anëtare të OECD, vlera e drejtë do të përcaktohet në bazë të çmimit të fundit të ofertës në blerje të realizuar në atë ditë në bursën e vendit të emetuesit ose në bursën e përcaktuar si burim primar i çmimit të letrës me vlerë dhe çmimi do të jetë i listuar/kuotuar zyrtarisht në shtypin financiar. Për letrat me vlerë të borxhit të tregtuara në tregjet e BE-së apo në tregjet likuide të vendeve anëtare të

OECD, vlera e drejtë do të përcaktohet në bazë të çmimit të fundit të ofertës në blerje zyrtarisht e listuar/kuotuar në shtypin financiar.

3. Në rastin e tregtimit në tregjet jashtë Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare të OECD-së, vlera e drejtë e aksioneve dhe të letrave me vlerë të borxhit, do të llogaritet në bazë të çmimit mesatar të tregtimit, sipas çmimit të listuar/kuotuar zyrtarisht, në ditën e tregtimit.
3. Në rastet kur në ditën e vlerësimit konstatohet se një ditë më parë “t-1” nuk ka patur tregtim, vlera e letrave me vlerë e nxjerr nga vlerësimi i ditës “t-2” do të konsiderohet si vlera e drejtë.

Neni 9

Vlerësimi i letrave me vlerë të borxhit me likuiditet të ulët

1. Letrat me vlerë të borxhit afatgjatë (*long-term debt*) të tregtuara në Republikën e Shqipërisë dhe që nuk janë tregtuar për 30 ditë nga dita e vlerësimit si dhe letrat e borxhit afatgjatë që tregtohen jashtë vendit dhe për të cilat çmimi i blerjes nuk është kuotuar për 30 ditë nga dita e vlerësimit, do të vlerësohen në bazë të metodës së amortizimit linear, me kusht që vlera fillestare është vlera e fundit e drejtë e përcaktuar për letrat me vlerë. Nëse tregtimi i të tilla letrave me vlerë ka rinisur pasi ato janë vlerësuar duke zbatuar metodën e amortizimit linear, këto letra me vlerë do të vlerësohen sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të këtij neni, nga dita e fillimit të tregtimit.
2. Me vazhdimin e tregtimit dhe përmbushjen e kushteve të vlerësimit të përmendura në nenin 6 të kësaj rregulloreje, asetet financiare do të fillojnë të vlerësohen në përputhje me parimet e vlefshme për kushtet e kuotimit të tyre në treg.
3. Letrat me vlerë të borxhit afatshkurtër (*short-term debt*) të një emetuesi nga Republika e Shqipërisë dhe që tregtohen po në Republikën e Shqipërisë dhe vlera e drejtë e të cilave nuk mund të përcaktohet për një periudhë për 30 ditë pas ditës së blerjes do të vlerësohen duke zbatuar metodën e amortizimit linear me kusht që vlera fillestare është vlera e fundit e drejtë e përcaktuar për letrat me vlerë. Në momentin e transaksioneve të reja në fond për letrat me vlerë të borxhit afatshkurtër të të njëjtit emetim, por me yield të ndryshëm maturimi, kjo vlerë e transaksionit do të përdoret si vlera e re e drejtë për letrat me vlerë të borxhit afatshkurtër të të njëjtit emitim.

Neni 10

Vlerësimi i letrave me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë

1. Bonot e thesarit të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë vlerësohen, në ditën e vlerësimit, duke u mbështetur në Yield e ankandit të fundit të bonove të thesarit dhe në numrin e ditëve të mbetura deri në maturim.
2. Obligacionet e emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë vlerësohen, në ditën e vlerësimit, duke u mbështetur në normën e interesit/yield të ankandit të fundit të bonove të thesarit dhe obligacioneve, si dhe në numrin e ditëve të mbetura deri në maturim.

Neni 11

Publikimi i informacionit

1. Shoqëria administruese e fondit të pensionit publikon vlerën neto të aseteve dhe vlerën neto të kuotës së fondit në ditën e vlerësimit.
2. Informacioni i paragrafit 1 të këtij neni publikohet në website e shoqërisë administruese të fondit të pensionit.

Neni 12 Raportimi në Autoritet

1. Me kërkesë të Autoritetit, shoqëria administruese e fondit të pensionit depoziton në Autoritet metodat e vlerësimit të përdorura për çdo lloj letre me vlerë, të cilat janë kontrolluar dhe miratuar më parë nga depozitari.
2. Autoriteti mund të urdhërojë shoqërinë administruese të fondit të pensionit të ndryshojë procedurën e vlerësimit të ndonjë letre me vlerë të veçantë nëse vëren se shoqëria ka përdorur çmimin e pasaktë të letrës me vlerë ose kur vlera e drejtë nuk korrespondon me situatën aktuale të tregut.

Neni 13 Asetet financiare të mbajtura për maturim

1. Investimet e klasifikuara nga shoqëria administruese e fondeve të pensionit si investime të mbajtur për maturim, do të llogariten me koston e amortizuar, duke zbatuar metodën e normës efektive të interesit të realizuar (yield) në momentin e çdo investimi fillestar. Norma efektive e interesit duhet të shprehet në katër shifra pas presjes dhjetore, dhe shifra e fundit do të rrumbullakoset duke aplikuar metodën matematikore të rrumbullakosjes.
2. Në rastin e shitjes së një pjese të aseteve të mbajtura për maturim, ose në rastin kur shoqëria e administrimit ndryshon synimin e saj ose humbet aftësinë për të mbajtur asetet deri në maturim, asetet totale të mbajtura deri në maturim do të rivlerësohen përsëri me vlerën e drejtë. Nga dita kur ndodh shitja e pjesshme apo riklasifikimi, asnjë letër me vlerë e mbetur nuk do të vlerësohet nga metoda e zbatuar për asetet financiare të mbajtura deri në maturim për dy vitet pasuese financiare. Përgjatë do të bëjnë rastet e shitjes dhe riklasifikimit me karakteristikat e përshkruara nga SNK 39.9.
3. Asetet financiare të mbajtura deri në maturim në përputhje me SNK 39 do të nënshtrohen testit të zhvlerësimit të tyre për çdo datë bilanci.
4. Asetet financiare të klasifikuara si llogari të arkëtueshme do të vlerësohen me koston e amortizuar, duke zbatuar metodën e normës efektive të interesit.

Neni 14 Kuotat e fondeve të investimit, si asete financiare të fondit të pensionit

1. Kuotat e fondeve të investimit, si asete financiare të fondit të pensionit, do të vlerësohen me vlerën neto të aseteve për kuotë të fondit përkatës, sipas publikimit në ditën e blerjes.

2. Në rastin kur vlera neto e fondit të investimit nuk është publikuar, ose kur vlera neto e aseteve për kuotë nuk është në dispozicion në ditën e vlerësimit, vlera e drejtë e kuotës së blerë do të jetë çmimi i kuotës në ditën e mëparshme të vlerësimit, pra çmimi më i fundit që është botuar për atë fond investimi nga shoqëria përkatëse e administrimit.

Neni 15

Llogaritja e detyrimeve për koston e administrimit

1. Detyrimet e fondit të pensionit ndaj shoqërisë administruese në lidhje me koston e administrimit llogariten çdo ditë, sipas formulës:

$$\text{Tarifa e administrimit} \times \frac{1}{365} \times \text{vlera neto e aseteve të asaj dite}$$

2. Detyrimet për koston e administrimit do t'i paguhet shoqërisë administruese të fondit të pensionit një herë në muaj, brenda dhjetë ditëve të muajit pasardhës.

Neni 16

Llogaritja e detyrimeve ndaj depozitarit

1. Shoqëria administruese llogarit çdo ditë detyrimet ndaj depozitarit për shërbimin që ofron ky i fundit. Llogaritja e detyrimit bëhet sipas formulës:

$$\text{Tarifa e shërbimit të depozitarit} \times \frac{1}{365} \times \text{vlera neto e aseteve të asaj dite}$$

2. Detyrimet për shërbimin e depozitarit do t'i paguhet Depozitarit një herë në muaj, brenda dhjetë ditëve të muajit pasardhës.
3. Kosto e shërbimit të depozitarit përfaqëson shpenzim të shoqërisë administruese.

Neni 17

Shpeshhtësia e vlerësimit dhe rakordimi me Depozitarin

1. Asetet e fondit të pensionit vlerësohen nga shoqëria administruese çdo ditë, në ditën e vlerësimit (t) dhe konfirmohen nga banka depozitare e fondit të pensionit.
2. Depozitari duhet të informojë shoqërinë administruese, për të cilën ofron shërbime depozitimi, mbi procedurën e verifikimit të llogaritjeve të vlerës neto të aseteve dhe detyrimeve të fondit, si dhe verifikimin e llogaritjes së vlerës neto të aseteve për kuotë.
3. Rakordimet mes shoqërisë administruese dhe depozitarit bëhen çdo ditë pune.

Neni 18

Raportimi i Depozitarit në Autoritet

1. Depozitari raporton në Autoritet për vlerën neto të aseteve të fondit të pensionit, për të cilin ofron shërbime depozitimi, si dhe për vlerën neto të çdo kuote. Forma dhe përmbajtja e këtij informacioni janë përcaktuar në Tabelën nr. 1, Shtojca 1, që është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.
2. Depozitari raporton në Autoritet brenda 3 ditë pune të muajit pasardhës, të dhënat ditore të të gjithë muajit paraardhës sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Depozitari raporton në Autoritet mbi portofolin e investimeve të aseteve të fondit të pensionit, për vlerën nominale dhe kontabël të këtyre aseteve si dhe për datën e maturimit të instrumenteve financiarë që përbëjnë portofolin e investimeve. Forma dhe përmbajtja e këtij informacioni janë përcaktuar në Tabelën nr. 2, Shtojca 1, që është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.
4. Depozitari raporton në Autoritet brenda datës 15 të muajit pasardhës, pas përfundimit të çdo tremujori të vitit, të dhënat mbi portofolin e investimeve sipas paragrafit 3 të këtij neni.
5. Të dhënat e përcaktuara në paragrafin 1 dhe 3 të këtij neni duhen të paraqiten në formë shkresore pranë Autoritetit si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë linkut vënë në dispozicion në faqen e Autoritetit.
6. Me kërkesë të Autoritetit, Depozitari raporton për procedurat e vlerësimit të aseteve të fondit të pensionit dhe detyrimeve të këtij të fundit.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi më datë 1 janar 2013.

KRYETAR

Enkeleda SHEHI

Shtojca 1

Tabela nr. 1

Informacioni mujor			
Data	Vlera neto e aseteve të fondit të pensionit (NAV)	Numri i kuotave të fondit të pensionit	Çmimi i kuotës i fondit të pensionit (NAV/Kuotë)

Tabela nr. 2

Portofoli i investimeve të fondit të pensionit					
Instrumenti	ISIN	Vlera nominale	Vlera kontabël	Monedha	Data e maturimit